

KRIZAT FINANCIARE

*Fidane Spahija, ass.
fidane.spahija@gmail.com*

Abstrakti

Krizat financiare edhe sot vazhdojnë të mbesin fenomene të pazgjidhura. Numri i llojeve të krizave çdo ditë po shënon rritje nga faktorë të ndryshëm ekonomik, politik, social, klimatik, financiarë, etj. Varësisht nga identifikimi dhe madhësia e krizës, variojnë pasojat e saj. Nëse kriza vrehet më herët, atëherë gjasat për parandalimin e saj janë të mëdha, në të kundërtën pasojat e saj mund të jenë galopante, siç është kriza e sotme financiare globale. Në kushtet e sotme të globalizimit, efektet e krizave përhapen shumë shpejt, kjo si pasojë e aktiviteteve ndërlidhëse financiare e tregtare që kanë prej shtetit në shtet. Në raste krizash shpeshherë ndërhyjnë qeveritë, bankat qendrore dhe institucionet tjera, ku qëllimi i vetëm është dalja apo lehtësimi i krizës. Masat kryesore që i ndërmarrin janë ulja e normave të interesit, ulja e normave të politikave fiskale (*tatimeve, taksave,*) etj., nëse kriza është me përmasa më të mëdha, atëherë ndërhyjnë edhe FMN-ja, Banka Botërore, Banka Qendrore Europiane, qeveritë e vendeve më të zhvilluara duke i ndihmuar me donacione, hua, ndihma humanitare, etj. Krizat duhet paraprirë duke hartuar plane në parandalimin e saj, por, nëse ndodh që kriza ka arritur në vendin e juaj atëherë duhet hartuar plane urgjente për tejkalimin e saj dhe plane “postkrizë” sepse përndryshe pasojat e saj mund të kenë kohëzgjatje të paparashikueshme. Të mos reagosh në kohë do të thotë ta pësosh dhe të vuash pasojat.

Fjalët kyçe: ekonomi, faktorët, globalizim, krizat, teknikat, pasojat, reagimet.

JEL klasifikimi: G, G0, G01.

HYRJE

- Me këtë punim shkencor bëhen përpjekje të sqarohen: Njohuritë mbi definimin e krizave financiare, llojeve të krizave nëpër periudha dhe vende të ndryshme duke i harmonizuar me shkaqet e tyre, me shembuj konkret sqarohen disa nga faktorët kryesor dhe pasojat e krizave, dhe krejtësisht në fund flitet rreth masave parandaluese dhe reagimeve të qeverive me bankat qendrore për daljen apo tejkalimin e krizave financiare. Në kuadër të tekstit “Krizat financiare”, përfshihen edhe elemente të krizës së sotme financiare globale.

- Për hartimin e punimit janë përdorur literatura të ndryshme vendore dhe të huaja, poashtu hulumtime në internet, media elektronike dhe të shkruara. Metodatat e përdorura për të arritur qëllimin e punimit kryesisht janë: analitike, krahasuese, abstraksionit, etj.

1. DEFINIMI I KRIZËS FINANCIARE

- Një krizë financiare zakonisht është një situatë kur kërkesa për para rritet në mënyrë të shpejtë. Deri para disa dekadash, krizat financiare ishin ekuivalente me krizat e bankave. Sot ato mund të kenë formën e çfarëdo krize që ka të bëjë me paratë. Shumë ekonomistë kanë ngritur teoritë se si zhvillohet një krizë financiare dhe si mund të përballohet. Sidoqoftë nuk ka një vijë të përgjithshme parandaluese dhe krizat financiare mbeten akoma një fenomen i rregullt.

Ndër sistemet më të rrezikuara të ekonomisë nga kriza financiare është sistemi financiar.

- Sistemi financiar, si nënsistem ekonomik dhe politik i çdo vendi, shquhet me veçoritë e tij specifike të cilat rezultojnë nga klima politike, nga karakteri i të drejtave të pronësisë, nga niveli i zhvillimit ekonomik, nga korniza legjislative e cila e favorizon ose jo krijimin e institucioneve të mirëfillta të ekonomisë së tregut dhe nga shumë faktorë e indikatorë të tjerë.⁵³ Sistemin financiar e përbëjnë shumë elemente që nga institucionet financiare (bankat qendrore, bankat komerciale, bankat e kursimeve, asociacionet kreditore dhe të kursimit, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensione – trustet, etj), ndërmjetësuesit financiar e deri tek tregjet dhe instrumentet financiare.⁵⁴

- Në kushtet e sotme të globalizimit, efektet e krizave financiare transferohen shumë shpejt prej vendit në vend. Këtë e dëshmoi edhe ekonomisti i shquar *Paul Krugman*, i cili tha se *“globalizimi nuk duhet parë si një fenomen që sjellë vetëm mrekulli, dhe as si një demon që sanksionon disa vende e popuj në favor të disa të tjerëve”*.⁵⁵ Përkundrazi, është fakti se globalizimi duhet parë më tërë kompleksitetin e tij se bota e globalizuar është më e ekspozuar ndaj krizave.

2. LLOJET E KRIZAVE FINANCIARE DHE SHKAQET E TYRE

- Një krizë financiare në një vend ka shumë gjasa të shkaktojë kriza të tilla dhe në një vend tjetër. Në raste të këtilla investitorët janë në dilemë se në cilin vend t’i vendosin apo t’i tërheqin mjetet e tyre. Kjo shkakton një ndalesë të fondeve për shumë ekonomi. Fakt interesant është se kompanitë e vendeve me ekonomi të qëndrueshme nuk dëshirojnë të financojnë në ato vendet të cilat i ka kapluar kriza sepse frikohen se nuk do t’u mbulohen shpenzimet e tyre dhe njëkohësisht kjo është si pasojë nga frika se mos po kalon kriza edhe në vendin e tyre.

⁵³ Prof. Dr. Safet Meroci “Tregjet financiare”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008, fq.25.

⁵⁴ Prof. Dr. Safet Meroci “Tregjet financiare”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008, fq.25-26.

⁵⁵ Adrian Civici “Kriza financiare apo globale”, UET Press, Tiranë, 2010, fq. 128.

- Ka një list krizash që kanë kapluar botën që kanë ndodhur në hapësira të ndryshme kohore dhe që kanë tundur themelet jo vetëm të një shteti. Disa prej krizave më të mëdha financiare në botë janë:⁵⁶

✓ *Paniku i vitit 1907*

“Paniku i vitit 1907” erdhi si pasojë e faktorëve të zakonshëm: ekspansioni i tepërt dhe arsyetimi i dobët. Tregu i bursës u rrënuar dhe kjo bëri që Banka Kombëtare e Amerikës së Veriut të falimentonte. Departamenti Amerikan i Thesarit u përpoq të dilte nga situata me paratë federale dhe me një riorganizmi krijues financiar. Tregu arriti të stabilizohej në shkurt të vitit 1908 dhe në maj Kongresi kaloi aktin “Aldrich-Vreeland”, i cili themeloi Komisionin Federal Monetar.

✓ *1912-’24: Superinflacioni gjerman*

Në vitin 1914 shkalla e këmbimit të dollarit amerikan me markën gjermane ishte 1 me 4. Në vitin 1923 shkalla e këmbimit kishte dalë aq shumë jashtë kontrollit sa që një dollar amerikan këmbuhej me 1 trilionë marka. Ideja e aq shumë parave nëpër duar duket e këndshme, por jo kur me to nuk blen dot as një bukë. Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore Gjermanisë iu kërkua dëmshpërblim material për koston e luftës. Si pasojë valuta vendase humbi vlerën. Atëherë, Gjermania vazhdoi të shtypë para deri sa u prodhuan një mijë miliardë marka. Superinflacioni mbaroi, por jo para se t’u shkaktonte dëme e hidhërimë një gjenerate të tërë gjermane.

✓ *1929: E marta e zezë*

Më 29 tetor 1929, 10 miliardë dollarë (rreth 95 miliardë dollarë sot) u kthyen në pluhur. Në vitet parardhëse të krizës, tregu i bursës “The Doë” po kthente në milionerë njerëz pafund. Ky lloj tregu u kthye në hobi për shumë investitorë injorantë, të cilët nuk dinin asgjë se si funksiononte tregu i bursës, por prapëseprapë ata vazhdonin të hidhnin lekët e tyre në rezervat e kompanive për të cilat nuk dinin asgjë. Kur qeveria hyri në lojë në përpjekje për të qetësuar gjërat duke rritur shkallën e interesit, lindi gjendja e panikut. Investitorët u përpoqën të tërheqin rezervat e tyre dhe fatkeqësisht edhe bankat kishin investuar në bursë. Kjo shkaktoi “Depresionin e Madh” që u pasua nga gjithë bota. Disa nga tiparet e kësaj krize, konsiderohen të ngjajshme me tiparët e krizës së sotme financiare globale.

✓ *1973: Kriza e naftës*

Në mes të luftës së tetorit ndërmjet Sirisë e Egjiptit kundër Izraelit, “OPEC” përdori naftën si një armë me “Embargon Arabe të Naftës” ndaj gjithë atyre që mbështetën Izraelin. Çmimet e naftës së papërpunuar u rritën, ndërkohë që prodhimi i saj u ndërpre sidomos ndaj SHBA-së dhe Holandës. Embargoja zgjati vetëm pesë muaj, por efektet e saj vazhdojnë dhe në ditët e sotme: shtetet anëtare të “OPEC” arritën një nivel mirëqenieje të paparë ndonjëherë: në gjashtë javë aksionet në “NYSE” (Bursa e Nju Jorkut) humbi afro 97 miliardë dollarë në vlerë dhe SHBA futi në fuqi limitin e shpejtësisë për të kursyer naftën.

✓ *1982: Kriza “Souk Al-Manakh”*

Tregu i bursës së Kuvajtit “Soul Al-Manakh” ishte një treg alternativ dhe jo krejtësisht i ligjshëm, veçanërisht në krahasim me tregun e bursës zyrtar të vendit.

⁵⁶ <http://www.shqiperia.com/kat/m/shfaqart/aid/2712/Dhjete-krizat-financiare-qe-tronditen-boten.html>

Sidoqoftë, shumë investitorë të rinj nuk kishin shumë akses në tregun zyrtar ndaj filluan të investojnë në “Souk Al-Manakh”. Aksionet kryheshin me çeqe të dala jashtë përdorimit dhe ky akt krijoi një kështjellë rëre që shumë shpejt u përmbys. Mijëra investitorë kishin çeqe të dala jashtë përdorimit dhe shuma e atyre arrinte në rreth 94 miliardë dollarë. E vërteta është se paratë ishin kthyer në fantazmë dhe vetëm dy banka i mbijetuan këtij shkatërrimi.

✓ 1987: *E hëna e zezë*

Pse e hëna e 19 tetorit 1987? Pse një shkatërrim masiv i tregut të bursës? Si u zhdukën në hiç 500 miliardë dollarë nga NYSE (Bursa e Nju Jorkut)? Edhe pas shumë vitesh nuk ka një përgjigje të saktë, dhe pjesërisht sepse nuk kishte pothuajse fare shenja që të paralajmëronin atë që do të ndodhte. Cilado të ketë qenë arsyeja, tregjet botërore u tronditën rëndë. Në fund të tetorit të vitit 1987, tregu australian ra 41.8 përqind, i Kanadasë 22.5 përqind, i Britanisë së Madhe 26.4 përqind. Një teori e përgjithshme ia atribuon këtë shkatërrim një programit të tregtisë së menjëhershme dhe influencës në rritje të kompjuterëve në “Ëall Street”.

✓ 1994: *Gabimi i dhjetorit*

“Gabimi i dhjetorit” buron nga nevoja urgjente e qeverisë meksikane për të korrigjuar disa gabime monumentale të lëna pas nga administrata që kishte lënë postin. Viti që çoi në “gabimin” ishte aq i turbullt sa mjaftonte për të trembur çdo investitor të mundshëm. Bëhej fjalë për shpërthime rebelësh në Ciapas, zëra për korruptimin në nivelet më të larta të qeverisë dhe disa vrasje politike. Administrata e presidentit Ernesto Zedillo nuk gjeti zgjidhje tjetër përveç se të zhvlerësonte peson. Kjo lëvizje shkaktoi që paratë të dilnin aq shpejt jashtë vendit duke tronditur edhe vetë qeverinë.

✓ 1997: *Krizat financiare të Azisë Lindore*

E ashtuquajtura “mrekullia ekonomike aziatike” rezultoi shkatërrimtare në korrik të vitit 1997, kur investitorët bënë atë që dinë të bëjnë më mirë: humbën sigurinë tek bursa. Kursi i lartë i prodhimeve i bëri tregjet aziatike tërheqëse, por kur SHBA uli normat e interesit, tregjet aziatike filluan të jenë në rrezik. Si pasojë ndodhi efekti domino duke filluar në Tailandë, për të përparuar në Filipine, Hong Kong, Indonezi, Malajzi dhe si pasojë duke shkaktuar kriza globale. Tregjet aziatike që ishin përballur me një prosperitet të rrallë deri atëherë pësuan humbje të mëdha.

✓ 1998: *Krizat financiare ruse*

Korrupsioni, mungesa e reformave efektive ekonomike, rënia e vlerës së rublës dhe mungesa e stabilitetit politik bënë që Rusia të përballej me kriza masive financiare. Si pasojë, duke qenë eksportuese e një të tretës së naftës dhe gazit natyror të botës, Rusia u godit akoma më shumë kur këto çmime ranë. Kur investitorët e huaj tërhoqën paratë e tyre nga vendi, bankat u dëmtuan një shkallë jashtëzakonisht të madhe. Krizat kapluan dhe vende si Ukraina dhe Republika Çeke duke prekur direkt tregun e bursës “The Doë” që përjetoi një prej uljeve më të mëdha të pikëve në histori.

✓ 1999: *Kriza ekonomike e Argjentinës*

Viti 1980 ishte shumë i vështirë për Argjentinën: diktatura ushtarake, rënia ekonomike dhe inflacioni masiv. Borxhi i vendit u rrit gjatë gjithë viteve '90 dhe duke i shtuar këtu dhe korrupsionin vendi u përball me një rënie të pashmangshme

në vitin 1999. Investitorët humbën besimin dhe largimi i tyre drastik e detyroi qeverinë që të ngrinte llogaritë bankare për një vit rresht duke lejuar vetëm tërheqje të vogla. Demonstratat u pasuan nga protesta të dhunshme, të cilat shkaktuan rënien e qeverisë së Fernando de la Rúa.

Këto konsiderohen disa nga krizat të cilat kanë trondit botën, pa e mohuar edhe krizën e sotme financiare e cila konsiderohet si kriza e parë e këtij lloji në epokën e globalizimit.

3. DISA NGA FAKTORËT E KRIZAVE FINANCIARE

- E keqja është se krizat nuk vijnë si njëra-tjetra dhe më e keqja se gjithkush në pushtet mendon që ajo nuk do të trokasë në ekonomine e tij, ose dhe nëse shfaqen shenjat e para, mendojnë se ajo do evitohet.

- *Falimentimi i një tregu burse* është shembulli më i mirë i një krize financiare që nuk prek vetëm vendin, në të cilin ndodhet por investitorët nga e gjithë bota që kanë investuar aty paratë e tyre. Në një ekonomi të hapur moderne, financat e një vendi janë shpeshherë të varura nga zhvillimi ndërkombëtar. Kriza financiare definohet si një situatë në të cilën furnizimi i parave është i shoqëruar nga kërkesa për para. Kjo do të thotë se likuiditeti është zhdukur me shpejtësi për shkak se të hollat që janë në dispozicion, tërhiqen nga banka e që ndryshe quhet edhe “*terheqje në vrapim*”, duke i detyruar bankat ose për të shitur më shumë ose për të bërë investime të tjera e cila vjen deri te mungesa e likuiditetit bankës apo mund të shkaktojë edhe kolapsin ose dështimin fundamental. Në këtë rast mund të vërehet edhe recesioni.⁵⁷

- Në raste krizash vërehet një përkeqësim i mprehtë i grupeve të treguesve financiar, të tilla si e normave të interesit afat-shkurtër dhe e çmimeve të aseteve, potencialisht të shoqëruara edhe nga dështimet e institucioneve financiare.⁵⁸

- Egzistojnë shumë faktorë të cilët shkaktajnë kriza financiare. Ndër dhjetë faktorët kryesorë të krizës globale është *jostabilitetiti financiar*.⁵⁹ Origjina e krizes financiare fillon me *krizat bankare dhe lëvizjen e çmimeve të aksioneve dhe letrave tjera me vlerë*.⁶⁰ Si faktorë kryesorë të krizave financiare janë edhe vet *rreziqet financiare*. Ndër rreziqet kryesore financiare e sidomos të bankave janë: rreziku nga humbjet, rreziku nga tërheqja e depozitave, rreziku i normës së kamatës dhe fluktuimet e pavolitshme të kurseve devizore të jashtme.⁶¹

Këto lloje të rreziqeve janë faktorë në humbjen e likuiditetit dhe solventitetit të shumë bankave të cilat mund të pasojnë deri te *falimentimi apo kolapsi bankar* – i cili njihet si faktor i krizave financiare. Faktorë tjetër i krizave financiare është *menaxhimi i dobët i autoriteteve qendrore* dhe mungesa e intervenimit të shpejtë të

⁵⁷ <http://www.businessdictionary.com/definition/financial-crisis.html>

⁵⁸ <http://www.highbeam.com/doc/1O104-financialcrisis.html>

⁵⁹ Bjørn Lomborg “Global crises, global solutions”, Cambridge University Press, USA, 2004.

⁶⁰ Franklin Allen and Douglas Gale “Understanding financial crises”, Oxford University Press, New York, 2007.

⁶¹ Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Menaxhmenti bankar” Prishtinë, 2004, fq. 99

bankave qendore apo edhe qeverive të vendit mbi institucionet që janë në gjendje krize.

Në shumë vende të botës thuhet se faktorë kryesorë të krizave janë edhe vetë *menaxherët e firmave të mëdha financiare* që janë të ndërlidhur me qeveritë e vendit apo edhe menaxherët kryesorë të bursave të tregjeve të ndryshme financiare. *Kreditimi i madh* konsiderohet si faktori kryesorë i krizës financiare globale dhe me pasoja shumë të mëdha për botën në përgjithësi. Faktorët e krizave janë të ndryshëm vlen të theksohet se edhe *investimi i mjeteve në mënyrë të gabuar* e sidomos për firmat me kapital të madh ndikon ashpër në ekonominë e vendit, ku efektet e saj mund të jenë madhore, si rasti i krizës së fundit nga firmat e SHBA-ve, njëkohësisht *rregullimi i dobët i qeverisë për politikat monetare dhe fiskale të vendit* sjell situata të pafavorshme dhe ndihmon në përshpejtimin e krizave financiare.

- Faktorët e krizës janë të shumtë por duhet pasur kujdes në parandalimin e tyre sepse pasojat e tyre janë të mëdha dhe ndërlidhëse të cilat pasojnë prej shtetit në shtet përmes kanaleve tregtare dhe financiare.

4. PASOJAT E KRIZAVE FINANCIARE

- Duke e pasur parasysh se faktorët e krizave janë të shumtë normalisht se edhe pasojat e saj janë të mëdha. Edhe ata që nuk janë ekspertë mund t'i përshkruajnë pasojat e krizës duke e parë realitetin që po shihet, por për atë se deri ku do të shkojë kriza është e pamundur që të parashikohet.

- Kohë të gjatë, në teorinë ekonomike botërore pati sunduar teoria e ligjeve të tregut të lirë. Me bindjen se tregu është rregullatori i të gjitha problemeve ekonomike. Tregu, si uji i lumit do e gjejë rrjedhën me të mirë dhe do të gjejë zgjidhjen e nevojshme më të mirën. Prandaj sa më pak barriera shtetërore tregut, sa më pak intervenime shtetërore dhe vetë tregu është një autorregullatore ekonomik. Ekonomia e tregut të lirë u bë model i zhvillimit dhe progresit ekonomik botëror, ajo kaloi barrierat kombëtare dhe u bë ligji i zhvillimit të mbarë ekonomisë botërore. Globalizmi dhe tregu i lirë botëror u bënë parimet e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Të gjithë organizmat ndërkombëtar, si Banka Botërore, shtetet e fuqishme ekonomike, parime të zhvillimit dhe bashkëpunimit vunë ekonominë e tregut të lirë dhe eliminimin e intervenimeve shtetërore. Sa më pak intervenim të shtetit sa më tepër liri veprimit të tregut - ky ishte parimi kryesor ndërkombëtar. Dhe ky parim forcoj më shumë tregun e lirë dhe dobësoi ndikimin e qeverive dhe bankave qendrore e cila u pasua me kriza të shumëta edhe në ditët e sotme. Pasojat dhe dëmet e krizave varen nga madhësia e krizës dhe hapi i ndërmarr për daljen apo lehtësimin nga kriza. Pasojat mund të jenë të natyrave të ndryshme por janë shumë të ndërlidhura në mes vete.

- Në rastin e krizës së fundit financiare shumë banka dhe institucione tjera financiare falimentojnë si pasojë e jolikuiditetit dhe josolvabiliteti (*pafuqia e kthimit të borxheve*) të huamarrësve dhe rënies së çmimeve të sektorit imobilier për huat hipotekare me rreziqe, pasojë ndërlidhëse e saj është se dëmtohen paratë e klientëve

që i kanë pasur në këto institucione financiare, papunësia rritet, fillon ç'regullimi i ekonomisë në tërësi, vazhdon rënia e tregut të letrave me vlerë, krijohet panik për institucionet tjera, rritet varfëria dhe shumë pasoja ndërlidhëse nga krizat financiare që sjellin në gjendje të mjerueshme ekonomitë e vendit.

- Në raste të krizave financiare normat e interesit bien, vlera e parasë humbet apo zhvlerësohet në krahasim me valutat tjera, shtetet e zhvilluara frikohen nga pasimi i efekteve të krizës dhe ndalojnë së qarkulluari mallrat (importet-exportet) e tyre, interesimi për investimi nga vendet tjera bie sepse askush nuk është i interesuar të punojë pa fitim dhe në gjendje krize. Kështu, mund të arrihet deri tek një papunësie e madhe e cila pason me imigrimin e shtetasëve në vendet e tjera.

- Buxhetet publike vuajnë shumë gjatë krizave financiare si pasojë e zvogëlimit të ardhurave nga recesioni e nga ana tjetër kemi rritje të shpenzimeve si pasojë e politikave mbështetëse sociale dhe prej shpenzimeve të paketave stimuluese të ekonomisë dhe sistemit financiar që shtetet i ndërmarrin.

- Pra, pasojat e krizave janë të ndërlidhura me njëra tjetren dhe efektet e tyre gjithmonë janë negative, qofshin të mëdha apo të vogla ato.

5. MASAT PARANDALUESE DHE TEKNIKAT E MENAXHIMIT ME KRIZA FINANCIARE

- Duke e ditur se sistemi financiar është i rrezikuar nga krizat e ndryshme financiare si pasojë e humbjeve, ndryshimeve në normat e kamatës dhe fluktuimeve të pavolitshme të kurseve devizore jashtë vendit, është e domosdoshme të bëhen përpjekje për dalje nga kriza apo edhe ndërmarrjen e masave dhe teknikave të ndryshme të menaxhimit për lehtësimin e krizës. Masat parandaluese dhe hartimi i teknikave të menaxhimit të krizës bëhet nga ana e vet institucioneve përkatëse që të mbrohen nga kriza, në raste kur institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat e ndryshme nuk mund të menaxhojnë me krizës atëherë mund të ndërhyjnë edhe institucione të tjera siç janë: Bankat Qendrore, qeveritë, institucionet për menaxhim me kriza, etj.

- Fillimisht gjatë krizave duhet evituar llojet e rreziqeve që cenohet vendi, pastaj të matet madhësia dhe vlerësimi i rrezikut dhe së fundi, hartimi i planit apo teknikave të menaxhimit të asaj krize. Rol të rëndësishëm gjatë krizave luan aftësia e menaxherëve të institucioneve dhe identifikimi në fazën sa më të hershme të krizës në mënyrë që pasojat të jenë sa të vogla, në të kundërtën nëse edhe BQ-ja dhe qeveria e menjanon këtë gjendje, pasojat mund të jenë marramendëse sikurse kriza financiare globale. Sa i përket, institucioneve financiare e sidomos bankave duhet të ruanë likuiditetin e vet duke krijuar rezerva të mjaftueshme në formë valuteje dhe t'u ikin sa më shumë efekteve të panikut në mënyrë që të mos u ikin depozituesitë e tyre.

- Sipas ekonomistëve dhe ekspertëve të ndryshëm për zvogëlimin e e efekteve të krizës siç është kjo e tanishmja duhet ndërmirren gjithashtu masat dhe politikat e zhvillimit "*postkrizë*". Politikat buxhetore, monetare, ekonomike e financiare, tregtare e sociale duhet të përmbajnë dy aspekte themelore: *së pari*, të

zvogëlojnë sa më shumë që të jetë e mundur efektet aktuale të krizës dhe *së dyti*, të kenë hapësirën e nevojshme për t'iu paraprirë situatave dhe zhvillimeve “postkrizë”.

- Sipas takimi të G20-ës që u mbajt në prill 2009, rëndësi e veçant për tejkalimin e krizës iu kushtua “ndërtimit të një arkitekture të re financiare globale” dhe detyrimeve të çdo vendi të veçantë për t'u bërë pjesë e saj.

6. REAGIMET E QEVERIVE DHE BANKAVE QENDRORE GJATË KRIZAVE FINANCIARE

- Një ndër shkaktarët e krizës financiare globale konsiderohen edhe vetë bankat qendrore dhe qeveritë e vendit sepse mbikëqyrja e tyre është e një niveli të ulët, sa që institucionet financiare mund të ofrojnë produkte të ndryshme konsumatorëve më shumë se që u lejohet në treg, pra oferta e tejkalon kërkesën, pa e analizuar fare situatën se mund të sjellë çregullime të panevojshme në tërësi ekonominë së një vendi. Por, nuk mund të mohohet fakti se në raste të nevojshme dhe në kohën e duhur qeveritë dhe bankat qendrore mund të konsiderohen shpëtimtarë të krizave. Në raste krizash, zakonsiht bankat qendrore i ulin ndjeshëm normat e interesit.

- Sipas Stiglitz, sot ekzistojnë *“instrumenta, politika monetare dhe fiskale dhe ne dimë si të parandalojmë një tjetër Depresion të Madh”*. Nëse kanosen nga depresioni qeveritë dhe BQ-të mund të përdorin me efektshmëri politikën lehtësuese monetare (*duke ulur normat e interesit*), si dhe stimulimin fiskal (*uljen e taksave për bizneset e individët*) dhe rritjen e investimeve publike për t'i dhënë frymëmarrje veprimtarisë ekonomike.

- Në këtë krizë ekonomike financiare globale, më shumë se asnjëherë tjetër, qëllimi i masave drastike të qeverive, institucioneve ndërkombëtare, bankave qendrore, e liderëve politikë të botës, ishte përveç të tjerave edhe për *“largimin e frikës dhe eliminimin e panikut”*. Shumë banka e tregje financiare shpëtuan pikërisht nga politikat dhe veprimet *“antipesimizëm e antipanik”*.

- Bankat qendrore insistojnë se mbajtja e inflacionit në një përqindje të ulët dhe stabël është kontributi më i mirë i politikës monetare.

PËRFUNDIMI

- Si rezultat i këtij punimi shkencor arrita në përfundim se krizat financiare janë fenomen shumë dimensional që vazhdojnë të jenë aktuale edhe në ditët e sotme.

- Krizat financiare janë shkaktarë kryesorë të: rënies së ekonomisë reale, falimentimit të ndërmarrjeve dhe institucioneve financiare, rritjes së deficiteve (*mungesave*) buxhetore, rritjes së papunësisë, rritjes së borxheve publike (*shtetërore*), rritjes së varfërisë, zhvlerësimit të vlerës së parasë dhe aseteve, ndryshimeve të normave të kamatës, normave të interesit dhe të valutave devizore, rënies së vlerës të letrave me vlerë (*aksioneve*), krijimit të inflacioneve dhe recesioneve në ekonomi, shtimit të migrimit nga vendi amë në vende të huaja, etj.

- Sipas parashikimeve tona të gjerëtanishme del se efektet e krizës së sotme financiare globale do ta prekin edhe Kosovën në aspektin e remitencave nga jashtë, export – importit, ashpërsimit të kriterëve për marrjen e kredive bankare, jolikuiditetit të NVM-ve, papunësisë, varfërisë, deficitit buxhetor, borxhit publik, etj.

REFERENCAT

1. Adrian Civici “Kriza financiare apo globale”, UET Press, Tiranë, 2010
2. Prof. Dr. Safet Merovci “Tregjet financiare”, Prishtinë, 2008.
3. George Cooper “The origin of financial crises”, Great Britain, 2008.
4. Sunanda Sen “ Global financial crisis”, ISID, 2008.
5. Buletine dhe raporte statistikore, Banka e Shqipërisë, Shqipëri, 2009.
6. Franklin Allen and Douglas Gale ”Understanding financial crises”, Oxford University Press, New York, 2007.
7. Shelagh Heffernan “Modern banking”, London, 2006.
8. Bjørn Lomborg “Global crises, global solutions”, Cambridge University Press, USA, 2004.
9. Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Menaxhmenti bankar”, Prishtinë, 2004.
10. <http://www.businessdictionary.com/definition/financial-crisis.html>
11. <http://www.highbeam.com/doc/1O104-financialcrisis.html>
12. <http://www.shqiperia.com/kat/m/shfaqart/aid/2712/Dhjetë-krizat-financiare-qe-tronditen-boten.html>

